



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:091212  
Datë: 27.03.2023  
Numri i dokumentit: 04125229

APS.nr.3/2023

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti Special, në Kolegjin Penal të përbërë nga gjyqtarët, Bashkim Hyseni kryetar, Burim Ademi dhe Ferit Osmani anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Alba Makolli, në çështjen penale kundër të akuzuarit G.R. për shkak të veprës penale Vrasje e rëndë nga neni 147 pika 3, 5 dhe 7 lidhur me nenin 23 të KPK-së, duke vendosur në lidhje me ankesën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar avokati B.T. dhe ankesën e mbrojtëses të akuzuarit G.R. avokate Kosovare Kelmendi, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.835/2020 të datës 05.12.2022, në seancën e kolegjit me datë 20.02.2023 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Me aprovimin e pjesshëm të ankesës së mbrojtëses së të pandehurit G.R. av. Kosovare Kelmendi, ndryshohet aktgjykimi i gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr. 835/2020 i datës. 05.12.2022, vetëm sa i përket cilësimit juridik të veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 147 par.3,5 dhe 7 lidhur me nenin 23 të KPK, për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, ashtu që në veprimet e të akuzuarit kjo gjykatë gjen se përmbushen elementet e veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 147 par.7 lidhur me nenin 23 të KPK.

Refuzohet si e pabazuar ankesa e përfaqësuesit të dëmtuarve, av. B.T., për sa i përket sanksionit penal.

Pjesa tjetër e aktgjykimit mbetet e pandryshuar.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, ka marrë aktgjykimin PKR.nr.835/2020 të dt.05.12.2022, me të cilin e ka shpallur fajtor të akuzuarin G.R. për shkak të veprës penale Vrasje e rëndë nga neni 147 pika 3, 5 dhe 7 lidhur me nenin 23 të KPK-së, dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) vite, në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar nën masën e paraburgimit prej datës 30.04.2009 deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit.

Konform nenit 60 par.1 të KPK-së, nga i akuzuari konfiskohet vetura e markës Golf II, me targa të regjistrimit .....

E dëmtuara B.H. nga fshati ... Komuna e Lipjanit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt pronësor juridik.

Është obliguar i akuzuari që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, kurse për fondin e kompensimit të viktimave të paguajë shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 300 (treqind) euro, të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi kanë parashtruar ankesë:

- Përfaqësuesi i palës së dëmtuar B.H. avokati B.T. për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që të aprovohet ankesa, të ndryshohet vendimi mbi dënim dhe ndaj të akuzuarit të shqiptohet dënim dukshëm më i rëndë, si dhe të njoftohen për seancën e kolegjit.

- Mbrojtësja e të akuzuarit G.R. avokate Kosovare Kelmendi për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënim, me propozim që të aprovohet ankesa, të ndryshohet aktgjykimi ashtu që i akuzuari të lirohet në mungesë të provave, të përjashtohen dëshmitë kundërligjore se aktgjykimi nuk mund të bazohet në dëshmitë që janë siguruar në mënyrë të kundërligjshme, konkretisht provat e konfiskuara në automjetin “Cali”, dhe për arsye të shkeljeve, aktgjykimi të priset – anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim.
- Përgjigje në ankesën e mbrojtjes, ka paraqitur Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, me propozim që ankesa të refuzohet si e pabazuar, meqenëse aktgjykimi është i bazuar në ligj dhe i arsyetuar.

Prokuroria e Apelit, ka paraqitur parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.43/23 të datës 20.01.2023, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e përfaqësuesit të palës së dëmtuar B.H. avokati B.T. dhe përgjigja e prokurorisë, aktgjykimi të ndryshohet dhe ndaj të akuzuarit të shqiptohet dënim më i lartë me burg, të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtëses të akuzuarit G.R. avokate Kosovare Kelmendi.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit konform nenit 390 par.1 të KPP-së, ku nuk ishte i pranishëm: Prokurori i Prokurorisë së Apelit edhe pse i njoftuar në mënyrë të rregullt për vendin dhe kohën e mbajtjes së seancës. Ndërsa, ishin të pranishëm përfaqësuesi i palës së dëmtuar avokati B.T., e dëmtuara B.H., i akuzuari G.R. me mbrojtësen e tij avokate Kosovare Kelmendi.

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të palës së dëmtuar, mbrojtjes, përgjigjen në ankesë të prokurorisë, propozimin e Prokurorisë së Apelit, dhe duke analizuar shkresat e lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

Ankesa e mbrojtëses se te pandehurit është pjesërisht e bazuar ndërsa ankesa e përfaqësuesit te të dëmtuarve është e pabazuara

*Pretendimet ankimore.*

Në ankesën e mbrojtëses të akuzuarit G.R. avokate Kosovare Kelmendi, pretendon se aktgjykimi përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.10, sepse aktgjykimi ka tejkalluar akuzën, për shkak të përfshirjes së veprimeve inkriminuese që nuk kanë qenë të përfshirë me aktakuzë. Mbrojtja paraqet kronologjinë e rastit duke iu referuar kështu aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë i cili ishte anuluar. Më pas pas anulimit të aktgjykimit, prokurorja pati ndryshuar aktakuzën ashtu që të akuzuarin O.S., e kishte shpallur fajtor për ndihmë pas kryerjes së veprës penale, për të cilin ka marrë formë të prerë kurse ka ndryshuar dispozitivin e aktakuzës. Gjykata e shkallës së parë, pati shpallur fajtor të akuzuarin sipas aktgjykimit PKR.nr.257/16 të dt.10.03.2020, dispozitivi i të cilit ishte identik me dispozitivin e aktakuzës së ndryshuar dhe të akuzuarin për të dytën herë e kishte dënuar me 30 vjet burgim, të cilin aktgjykim e kishte anuluar më pas Gjykata e Apelit. Në përfundim të shqyrtimit kryesor, prokurorja kishte mbetur pranë aktakuzës dhe dispozitivit të saj. Në rastin konkret, mbrojtja i është referuar dispozitivit të aktgjykimi i cili po atakohet, konkretisht përshkrimi faktik, që sipas mbrojtjes është evident tejkallimi i akuzës, me ç'rast gjykata e heq kohën e kryerjes së veprës penale (orën e saktë sikurse pretendon prokuroria nga 17:30 – 18:30), kohë kjo e përcaktuar nga ana e prokurorisë për 14 vite me radhë, duke e ndërruar me orët e papërcaktuara të pasdites, e përshkruan si vend të ngjarjes – vrasjes “Autoservis C...” të cilin për 14 vite me radhë prokuroria asnjëherë nuk e kishte përshkruar në dispozitiv të aktakuzës si vend ku është kryer vrasja, aktgjykimi përshkruan si motiv të vrasjes borxhin prej 2.000 euro, ndërkaq prokuroria as në aktakuzën e parë, e as atë të ndryshuar në fjalën përfundimtare, asnjëherë për 14 vite nuk e ka përshkruar si motiv borxhin, por si motiv ka përshkruar përfitimin e dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme, pa e përcaktuar se cila ishte ajo dobi, dispozitivi i aktgjykimit e heq në tërësi “marrëveshjen paraprake”, ashtu sikurse pretendonte prokuroria se ka ekzistuar për privimin nga jeta e të ndjerit N., e që paraqet elementin e parë që vrasja të jetë e cilësuar dhe e kryer me paramendim, dispozitivi i aktgjykimit përfshin veprime inkriminuese për të akuzuarin, që nuk kanë qenë të përfshira me aktakuzë asnjëherë, sikurse është përshkrimi “e godasin në mënyrë dinake”. Pra, të gjitha paraqesin tejkallim të aktakuzës. Aktgjykimi, përfshin shkelje nga neni 365 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së, sepse dispozitivi nuk përmban përshkrimin e fakteve dhe rrethanave që përbëjnë figurën e veprës penale, nuk janë përshkruar veprimet e sakta si dhe pasojat e veprimeve të akuzuarit G. dhe personit N.N me nofkën “Qeli”, në përgjithësi. Aktgjykimi përmban shkelje edhe nga neni 384 par.1 nën par.1.12 dhe par.2 nën par.2.1 lidhur me nenin 370 par.6 dhe 7 të KPP-së. Nga materiali argumentues, nuk mund të nxjerrët përfundim i qartë dhe bindshëm se cilat janë veprimet konkrete të akuzuarit G., në të cilat inkorporohen elementet e veprës penale të vrasjes. Në rigjykim, gjykata nuk i ka zbatuar udhëzimet dhe rekomandimet e

gjykatës së Apelit, por ka bërë shkelje të reja thelbësore. Bastisja në autoservis “C..”, është zbatuar pa urdhëresë të gjykatës sikurse për datën 30.04.2009, ashtu edhe për datën 01.04.2009 dhe kjo nuk është kontestuese. Prandaj, aktgjykimi bazohet në dëshmi – prova të kundërligjshme që paraqet shkelje esenciale nga neni 384/1.8 të KPK-së. Nuk ekziston asnjë provë materiale, se bastisja është lejuar nga gjykata me shkrim apo verbalisht. Nuk ka urdhër me shkrim, madje edhe policia, prokurori nuk deklarojnë që urdhri të jetë dhënë. Nëse, gjykata do të jepte urdhër verbal, atëherë në shkresa do të ekzistonte raporti policore, ku gjykata do të vërtetonte ligjshmërinë e kryerjes së bastisjes, në këtë mënyrë është shkelur neni 111 i KPP-së dhe neni 257 që përmban rregullat e përgjithshme të prezantimit të dëshmive. Aktgjykimi, nuk sjell asnjë arsyetim apo përgjigje në argumentet e mbrojtjes se gjatë bastisjes, dëshmitarët nuk kanë qenë prezent, bastisja ka filluar 24 orë më herë se fillimi i evidentuar në procesverbal, policia ka qenë në autoservis shumë kohë vetëm, pa prezencë të dëshmitarëve, që pronarit nuk i është garantuar e drejta për prezencë të avokatit, që me dëshmi nuk është vepruar në përputhje me ligjin e që kushtëzon përjashtimin – veçimin e provave të konfiskuara. Sipas ankesës, është shkelur edhe neni 7 i KPRK-së. Po ashtu, aktgjykimi përmban shkelje nga paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të nenit 384 dhe nenit 5 të KPP-së, dhe si i tillë është i paligjshëm. Sipas ankesës, është shkelur edhe e drejta kushtetuese nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i GJEDNJ.

Lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mbrojtja konsideron se gjendja faktike është në kundërshtim me provat si pjesë e shkresave të lëndës, e siguruar gjatë fazës hetimore dhe shqyrtimit kryesor. Mbrojtja, sërish i është referuar aktvendimit të Gjykatës së Apelit PAKR.nr.185/2020, ku janë dhënë vërejtjet dhe sugjerimet eksplicite. Në rigjykim, çështja e çekiçit është sqaruar, fal dëshmitarit XH.R., i cili kishte dëshmuar se çekiçi kishte qenë sajësë e tij, se kishte gënjyer të dy familjet vetëm për të përfituar të holla. Nga dëshmitarët e prokurorisë, asnjëri nuk ka implikuar drejtpërdrejt të akuzuarin G., në vrasjen e tani të ndjerit N.H.. Mbrojtja, i është referuar deklaratës së dëshmitarit të dëmtuarit H.H., i cili ka dëshmuar me rrethanat e zhdukjes së vëllait të ndjerë të N.it, por njëkohësisht nga ky dëshmitar rrjedh edhe dyshimi rreth motivit për këtë vrasje, e që rezulton një borxh në një shumë të pa përcaktuar, që për mbrojtjen dëshmia e tij në shqyrtim kryesor ka kundërthënie qoftë rreth shumës së parave qoftë rreth dyshimeve të tij, sikurse edhe objektiviteti i tij si i dëmtuar, pjesë me relevancë paraqet edhe deklarimi i tij për thirrjen telefonike të cilën e ka pasur derisa ishte duke dhënë deklaratë në polici. Në këtë kontekst, përmendet edhe deklarata e të dëmtuarës B.H. e dhënë në prokurori me datë 23.10.2009. Dëshmitari F.R., vërteton bastisjen e kundërligjshme pa urdhëresë të gjykatës tek autoservis “C...”, sikurse edhe veprimet e kundërligjshme dhe jo profesionale të

hetuesve policor gjatë bastisjes. Dëshmitarët kryesor të hetimit të kësaj ngjarje kritike, janë hetuesit policor E.B., Z.G. dhe L.RR.. Mbrojtja propozon, që të analizohen dëshmitë, por edhe veprimet e hetuesve dhe të krahasohen me dëshminë e dëshmitarit O.S., sepse gjykata ose do ti besoj versionit të tre hetuesve diametralisht të kundërt mes deklaratimeve të tyre dhe veprimeve të tyre të kundërligjshme dhe jo profesionale, ose versionit të mbrojtjes të akuzuarit. kombinimi i të dyjave nuk mund të bëhet sepse dy të “vërteta” nuk ekzistojnë. Njëra palë e thotë të pavërtetën ose hetuesit ose i akuzuari O.. Mbrojtja i është referuar në veçanti deklaratave të hetuesve dhe kundërthënieve që paraqesin në deklaratimet e tyre, fillimisht dëshmitarit E.B., qoftë me faktin se si e kishin gjetur kufomën ende të tymosur rreth orës 15:00, kurse vrasja sipas akuzës thotë se ka ndodhur mes orës 17:30 – 18:30, por edhe kundërthënieve të tjera. Më pas, mbrojtja i referohet edhe hetuesit Z.G.t, përpiluesit të kallëzimit penal, si dhe L.RR. pjesëtarit të tretë të trekëndëshit hetues. L.RR., i pari sipas deklaratimit të tij ka përcaktuar vendin ku është vra i ndjeri N.. Pra, njollat e gjakut në shumë vende, boca e oksigjenit me njolla gjaku, byku i shpërndarë, tri copa të qebes identike me atë që ia ka thënë Valbona me telefon dhe qeset e najlonit të cilat ishin të njëjta me qesen në vendin ku është gjetur viktima, të cilën fare nuk e kishte parë. Të gjitha këto, pa urdhëresë gjykate, pa fotografim nga forenzika për të cilën vetëm L. po thotë se kanë qenë atë natë, as Z., as Emini e as vet Forenzika. Vendi ku qenka vra i ndjeri, ende pa u kontrolluar asnjë autoservis tjetër, pa u ndërmarrë asnjë veprim hetimor, zyrtarët policor e konstatojnë se vendi ku i ndjeri është vra është autoservis C.... Sipas kallëzimit penal dhe raportit zyrtar, provat janë mbledhur me datat 30 prill dhe 1 maj 2009, andaj të njëjta është dashur të shpallen prova të papranueshme. Ndërsa, ish i akuzuari tani dëshmitar O.S., ka deklaruar se ditën kritike që nga mëngjesi deri në mbrëmje ka qenë në autoservis “C...” ku ka punuar, dhe i ndjeri nuk është vra në autoservis dhe nuk dihet vendi ku është vrasë. Kurse, prokuroria me aktakuzë nuk e përcakton vendin e vrasjes, një ndër elementet kryesore, por e tejkalon akuzën duke e bërë një gjë të tillë, gjykata e shkallës së parë. Mbrojtja më tutje, i referohet dëshmitarit O.S.t, i cili sqaron detajisht të gjitha lëvizjet e tij personale dhe ato të akuzuarit G. që nga mëngjesi i hershëm i datës 29 prill, 30 prill e 1 maj 2009. Të ndjerin, e ka njohur dhe parë tre herë në jetën e tij në rrethanat që i ka shpjeguar. Madje, një herë kalimthi e ka parë edhe H. kur ka ardhur me marr njërën makinë të ndrequr por pa i ditur emër. Mbrojtja në ankesë, ka paraqitur dëshminë e këtij dëshmitari duke e cituar të njëjtën së bashku me pyetjet e mbrojtjes. Sipas ankesës, prokuroria ka arritur që në vend të O.it të vendos “Qelin”, cili është sajuar e më pas G.i është shndërruar në O.. Lidhur me administrimin e provave, vërejtjet e mbrojtjes kanë qenë të bazuara, veçanërisht me raportin e vendit të ngjarjes të datës 06.05.2009 të përpiluar nga zyrtari policor hetuesi L.R. në rrethanat se veprimet hetimore të cilat janë ndërmarrë nga këta hetues në autoservis, të cilat i kanë ndërmarrë

me datë 01.05.2009, duke e cekur autoservisin “Cali” si vend i ngjarjes, ndërkaq duke u thirr po ashtu se vendi i ngjarjes është vendi ku është gjet viktima tani i ndjeri N., rezulton se ky procesverbal ngjan në procesverbalin e kontrollit dhe bastisjes, e jo të vendit të ngjarjes. Nga ana tjetër, këto veprime janë bërë në mënyrë të kundërligjshme, sepse nuk ekziston urdhërese për kontroll apo bastisje edhe sikur të ekzistonte ky urdhër do të duhej që kishte me shkrim. Po ashtu, ekspertiza e dytë e ADN-së është kopje e ekspertizës së parë dhe po të dy ekspertizat, e vitit 2009 dhe 2014, mostrat e dorëzuara janë dorëzuar nga hetuesit, dhe jo nga krim teknika. Po ashtu, mostrat respektivisht provat e dërguara në laborator, janë dërguar 11 ditë pas vrasjes së ndjerit. Dhe e fundit, mungesa e ekzaminimit të rrobave të akuzuarit G.. Një dëshmitar i rëndësishëm, sikurse H.S. për 14 vite asnjëherë nuk ishte ftuar nga prokuroria, dhe fare nuk është përfshirë në aktgjykim, edhe pse është personi i parë që e ka hetuar viktimën me datë 30.04.2009 rreth orës 11:35, në mes të fshatit Smallush dhe Dobratin derisa kishte qenë duke punuar me traktor. Nga largësia, kishte vërejtur një makinë të zezë të parkuar në mes të rrugës kryesore të fshatit, ndërkaq kishte vërejtur një burrë dhe një grua tek vendi i kufomës së të ndjerit N., të cilët nga aty ishin kthyer tek makina e zezë e parkuar dhe me shpejtësi ishin larguar. Më pas, ky dëshmitar i cili në momentin kur i ka pa ata dy persona nuk ka qenë në dijeni se qëndron një kufomë, pas pak çastesh e vëren kufomën dhe lajmëron policinë. Ky dëshmitar nuk ka deklaruar se kufoma ishte duke tymosur, siç deklaratën hetuesi E.B., i cili kishte arritur tek kufoma disa orë pas dëshmitarit H.S.. Gjykata, është dashur të vërtetojë dhe arsyetojë marrëveshjen paraprake mes Qelit dhe të akuzuarit G. siç pretendohet në aktakuzë, se kush ishte Qeli dhe a ekziston ky person, a është besueshme dhe kredibile dëshmia e O.S.t lidhur me të akuzuarin G., cili ka qenë roli i Qelit e cili roli i G.it, cili nga këta dy persona ka pas motiv për vrasjen e të ndjerit, Qeli G.i apo të dytë, cila është koha kur është vra i ndjeri N., ku është vra, mos vallë trupi i tij ka qenë në gepek të BMW, se ku ka mbetur trupi i N.it, gjersa G.i dhe Qeli erdhën dhe morën shishe, a nuk do të duhej të kishte gjurmë dhe pëllg të gjakut dhe cilat ishin veprimet apo kontributi i të akuzuarit G..

Të gjitha shkeljet e lartcekura, kanë ndikuar edhe në shkeljen e ligjit penal në dëm të akuzuarit G., sepse i njëjti është akuzuar dhe shpallur fajtor pa u përshkruar veprimet e tij inkriminuese, për veprën të cilën nuk e ka kryer. Shkelja e ligjit penal, konsiston në faktin se në cilësimin juridik të kësaj vepre, nuk mund të përfshihet edhe paragrafi 3 edhe paragrafi 5, sepse të dy këto paragrafë përcaktojnë mënyrën e vrasjes mizorisht.

Sipas mbrojtjes, aktgjykimi i paligjshëm ka prodhuar edhe pasojën e vendimit mbi dënim. Në veçanti, tejkalimi i aktakuzës, përshkrimi dhe përfshirja e dinakërisë në dispozitiv të aktgjykimit,

që nuk ka qenë fare e përshkruar në dispozitiv të aktakuzës. Prokuroria, ashtu edhe gjykata kanë dështuar të përshkruajnë, veprimet individuale e inkriminuese të akuzuarit G., e viteve të fundit edhe të personit inekzistent me nofkën “Qeli”. Andaj, ankesa është e bazuar dhe si e tillë duhet aprovuar.

Në ankesën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar B.H. avokati B.T., propozohet një dënim dukshëm i ashpër, apo dënim maksimal. Kjo duke marrë parasysh, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, goditjet e shkaktuara me mjete të forta në kokë, lidhjet e duarve dhe këmbëve me tel metalik, lyerjen me benzinë të trupit të viktimës dhe djegien për së gjalli të ndjerit N.. Kjo sipas të dhënave, konsiderohet ndër veprat më të rënda që nga përfundimi i luftës. Gjykata ka nënvlerësuar rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, këmbëngulësinë dhe faktin se deri tani nuk është zbuluar personi NN, që ka kryer veprën penale me të akuzuarin G.. Ankesa, i referohet deklaratës së O.S.t, i cili ka deklaruar të gjitha veprimet që i ka ndërmarrë i akuzuari G., si kur e ka detyruar ta blejë në shishe benzinë, pastaj kur ishte ardhur me personin e quajtur “Qeli”, si e ka detyruar që ta pastrojë veturën Golf 2 dhe se si është detyruar që ta telefonojë vëllain e të ndjerit N., H.in dhe t’i thotë se N.i gjendet në Shkup. Po ashtu dëshmitari XH.R., ka shpjeguar se i është manipuluar nga familjarët e të akuzuarit G. lidhur me çekiçin. Mënyra e takimit me familjarët e të akuzuarit, premtimet që i janë dhënë nëse vepron sipas rekomandimeve të tyre, paratë që i ka pranuar nga familjarët e të akuzuarit, mënyra e furnizimit me derivate, takimi që ka pasur me vëllain e të akuzuarit G.. Sipas dëshmitarit, është munduar të njolloset edhe familja e të ndjerit N. për të inskenuar gjëra të pavërteta. Më e rëndësishmja, ky dëshmitar ka deklaruar se e ka identifikuar çekiçin, ka zbuluar skenarin, se si ishte siguruar, si ishte lyer me gjak të dhelprës dhe takimi me ish gjyqtarin e Gjykatës së Qarkut. Me dënimin e shqiptuar, nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit, veçanërisht marrë parasysh pasojat shumë të rënda, se i ndjeri ka lënë pas bashkëshorten dhe 5 fëmijë të vegjël dhe se i akuzuari në çdo formë është munduar t’i ikë përgjegjësisë penale.

Në përgjigjen në ankesën e mbrojtëses të akuzuarit G.R. avokate Kosovare Kelmendi, ka paraqitur Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, ku është theksuar se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar udhëzimet e Gjykatës së Apelit. Kështu, aktgjykimi nuk përmban kundërthënie mes dispozitivit dhe arsytimit. Gjykata, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, veçanërisht dëshmia e dëshmitarit XH.R.. Nga dëshmia e tij, ka rezultuar se disa vite pas ngjarjes, familja R. ishte marrë vesh me të që të dëshmojë dhe përgatis prova të rrejshme. Kjo rrethanë vërtetohet nga fakti, se për disa vite rresht me këmbëngulje është kërkuar dëgjimi i tij



nga mbrojtja. Andaj, ankesa është e pabazuar, ligji penal nuk është shkelur dhe vendimi mbi dënim është i arsyeshëm në raport me gjendjen faktike dhe rrethanat tjera.

### **Gjetjet e Gjykatës së Apelit**

Gjykata e Apelit ka gjetur se, pretendimet ankimore të mbrojtjes së të pandehurit, për sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, janë të pabazuara.

Kolegji vëren se pretendimet e mbrojtjes për sa i përket shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shtrihen në: Tejkalinimin e Akuzës, në mbështetjen e aktgjykimit në prova të papranueshme, në mungesën e arsyeve për faktet që gjykata i ka konsideruar se vërtetohen në raport me vlerësimin e provave për faktet e tilla.

Për sa i përket tejkalinimit të akuzës që mbrojtja thekson, se Gjykata ka shtuar faktet, se vendi i kryerjes së veprës penale është në Autoservisin C..., se është hequr koha e kryerjes së veprës penale, se është hequr fakti se kanë pasur marrëveshje paraprake, se dispozitivi përshkruan veprime për të pandehurin që nuk kanë qenë në aktakuzë, Kolegji në këtë çështje penale ka parasysh se për të vlerësuar aspektin e tejkalinimit të akuzës, duhet vlerësuar në kontekst të tërësishëm çështjen penale. Në rastin konkret, ky Kolegj nuk gjen se aktgjykimi i gjykatës se shkallës së parë ka tejkalluar akuzën. Fillimisht tejkalimi i akuzës duhet reflektuar në raport me ndryshimin e fakteve që si të tilla përcaktojnë elementet e një cilësimi tjetër juridik të veprës penale qoftë më të rëndë për të pandehurin. Roli i të pandehurit në raport me faktet e përshkruara në aktgjykim a ndryshon nga roli që është pretenduar sipas akuzës, si dhe ndryshimet e bëra a konsistojnë në ndryshime si fakte të reja apo kanë të bëjnë me rrethanat që precizojnë faktet e pretenduara në akuzë.

Mbi këto rrethana, Kolegji vlerëson se përshkrimi i dispozitivit si në aktgjykim, ka të bëjë me veprën penale të njëjtë të cilat fakte të përshkruara ndërtojnë figurën e vrasjes së rëndë, siç edhe i pandehuri ngarkohej me akuzën e Prokurorisë për të njëjtën veprë penale. Poashtu fakti se Gjykata ka hequr kohën ( orën e kryerjes së veprës penale) por që në dispozitiv thekson datën e njëjtë dhe përcakton si kohë të kryerjes pasditen e asaj date, kjo nuk ka të bëjë me tejkalim të akuzës, por thjesht me vërtetimin e fakteve që kanë rezultuar nga procesi i të provuarit, e që vërtetohet nga provat se i pandehuri është vrarë me datë, 29.04.2009 në orët e mbas ditës. Fakti se Gjykata ka hequr përshkrimin, “ në marrëveshje paraprake”, kjo rrethanë ka të bëjë me

bashkëkryerjen, dhe se heqja e një rrethane të tillë nuk e bënë të paqenë bashkëkryerjen, kur bashkëkryerja mund të shfaqet në dy forma: Qoftë duke pasur role konkret që së bashku kryejnë veprën penale apo duke kontribuar thelbësisht në kryerjen e veprës penale, rrjedhimisht Kolegji nga provat që ka administruar gjykata e shkallës së parë, ka konkluduar se i pandehuri së bashku me personin ende të paidentifikuar me nofkën “ Qeli” së bashku kanë kryer veprën penale, e që kjo konsumon formën e bashkëpunimit në kryerje të veprës që konsiston në bashkëkryerje, andaj kjo nuk përbën tejkalim të akuzës. Ndërsa, fakti se gjykata ka përshkruar disa rrethana nga të cilat kanë rezultuar nga provat që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor, rrethana këto që ndërlidhen me rrethanat që ishte kryer vepra penale, Kolegji gjen se këto rrethana që mbrojtja i pretendon kanë të bëjnë në kuadër të ngjarjes së njëjtë penale që ka ndodhur që janë në pajtueshmëri me procesin e të provuarit në shqyrtimin gjyqësor, dhe për më tepër konsistojnë në konkretizimin e ngjarjes së ndodhur, që si të tilla nuk i atribuohen fakteve që nuk rezultojnë nga procesi i të provuarit dhe nuk ka ndryshime të fakteve në kuptim të elementeve të figurës së veprës penale.

Për të gjitha këto arsye Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimi i mbrojtjes se aktgjykimi ka tejkaluar akuzën është i pabazuar.

Lidhur me pretendimet e mbrojtjes, për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, që theksohet se aktgjykimi është mbështetur në prova të papranueshme, Kolegji këto pretendime nuk i gjen të bazuara. Fillimisht, Kolegji ka parasysh se, gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye lidhur me shpalljen e provave të papranueshme që janë marrë nga autoservisi C... kur ka refuzuar propozimin e mbrojtjes që ato prova nuk janë marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore nga se nuk është dhënë urdhër gjyqësor. Kolegji i gjykatës së Apelit, vlerëson se provat që janë siguruar në autoservisin C..., janë të pranueshme, dhe atë për shkak se rezulton se nuk kemi të bëjmë me veprimet e policisë për bastisjen, por rezulton se kemi të bëjmë me shikim të vendit të ngjarjes në të cilin vend të ngjarjes janë siguruar gjurmët që kanë korresponduar me veprën e kryer penale. Nuk mund të rezultojë si vend i kryerjes së veprës penale vetëm vendi ku është gjetur viktima, por vendi ku është gjetur viktima dhe vendi ku ndaj tij kanë vepruar të pandehurit rezulton si vend i ngjarjes, nga se nga provat që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor, janë gjetur gjurmë që vërtetojnë faktin se viktima kishte qenë prezent në autoservisin C... ku edhe është goditur. Më konkretisht, në autoservisin C... dhe në tepihun e veturës Golf, rezulton se janë gjetur gjurmët e gjakut që në ekzaminim të ADN-se, ato kanë korresponduar se i takojnë të ndjerit. Këto gjurme vërtetojnë faktin se kemi të bëjmë me vend të ngjarjes ku ishte

ndërmarrë veprimi ndaj të ndjerit dhe pastaj në vend të ngjarjes ku ishte gjetur trupi, në këtë kuptim Kolegji vlerëson se kur kemi të bëjmë me vend të ngjarjes ku dyshohet se është kryer vepra penale, dispozitat e KPP-ës, nuk kërkojnë fare urdhër për bastisje për qëllim të sigurimit të atyre gjurmëve që mund të shndërrohen në prova, por dispozitat nga neni 201 ( Kodit të përkohshëm të procedurës penale që ishte në fuqi në kohën kur ishte kryer vepra penale), veprim ky i përcaktuar edhe me kodin e procedurës penale si autorizim i policisë, në nenin 70 ( Kodi i procedurës penale 2012, por i përcaktuar edhe me nenin 71 të Kodit të procedurës penale aktual në fuqi). Nga ky këndvështrim, Kolegji vlerëson se përderisa rezulton se kemi të bëjmë me vend të ngjarjes veprimet e policisë për sigurimin e vendit të ngjarjes dhe ruajtjen e marrjen e gjurmëve janë tërësisht të mbuluar me këto dispozita, dhe nuk kemi të bëjmë me kontroll që mbrojtja pretendon se është dashur ekzistimi i urdhrit gjyqësor.

Lidhur me pretendimet e mbrojtjes se, aktgjykimi është mbështetur në deklaratën e të bashkëpandehurit, O., kolegji një pretendim të tillë e gjen të pabazuar, pasi që nga deklarimi i këtij dëshmitari rezulton se, ai ka sqaruar rrethanat për veprimet e tija dhe rrjedhimisht ai ne asnjë moment nuk ka theksuar për ndonjë veprim të drejtpërdrejt të të pandehurit G. që do të konsiderohej si deklaratë që nuk mund të mbështetet fajësia. Deklarata e dëshmitarit O., sqaron disa fakte që në tërësinë e çështjes penale kanë rëndësi, e që janë se ai ka pohuar se ka shkuar dhe ka blerë një shishe benzinë sipas kërkesës së G.it, poashtu se ai ka vërejtur se në garazhin e të pandehurit G. ishte derdhur vaj i automjeteve që babai i të pandehurit G. kishte kërkuar nga ai që ti hedh Byk, poashtu ka sqaruar se i pandehuri G. i ka dhënë telefonin për ta thirrur vëllain e të ndjerit dhe ai e ka thirrur dhe i ka thënë mos e kërko vëllain në polici se e ke ne Shkup, për të cilat rrethana ai edhe është dënuar, pra deklarimi i këtij dëshmitari konsiston në deklarimin e veprimeve të tija, por që në tërësinë e çështjes penale këto fakte të pohuara nga ana e dëshmitarit O., kanë rëndësinë e tyre për vërtetim të tërësisht të gjendjes faktike, megjithatë deklarata e tij në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet si deklaratë në kontekst të provueshmërisë së fajësisë së të pandehurit G..

Lidhur me pretendimin e mbrojtjes se aktgjykimi është i përfshirë me shkelje esenciale, pasi që gjykata nuk ka dhënë arsye për sa i përket fakteve që i konsideron të vërtetuara dhe fakteve që i konsideron të pavërtetuara, ne raport me provat që janë administruar, Kolegji vlerëson se aktgjykimi në dispozitiv shpërfaq qartë rrethanat faktike që konsumojnë elementet e figurës së veprës penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri. Poashtu, në aktgjykim gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye në raport me faktet dhe provat që ka administruar në shqyrtimin

gjyqësor, e që janë te mjaftueshme për të marr vendimin e ligjshëm në këtë çështje penale, nga këto shkaqe Kolegji e gjen të pabazuar pretendimin e mbrojtjes për sa i përket mungesës së arsyeve për faktet dhe provat në aktgjykimin e ankimuar.

Kolegji ka parasysh pretendimet e mbrojtjes lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, të cilat pretendime shtrihen në drejtim të arsyeve të dhëna nga mbrojtja për mospërputhjet e disa deklaratave të dëshmitarëve, siç janë: H. H., B.H., F.R., E.B., Z.G., L.RR.. Që të gjithë këta dëshmitarë mbrojtja iu referohet për rrethanat që ata kanë kundërshtime në disa pjesë të deklaramit të tyre. Megjithatë, Kolegji vlerëson se në këtë çështje penale, dëshmitarët kanë rëndësi për faktet e ndërmjetme të kësaj çështje penale, ndërsa gjurmët që janë gjetur – si gjurmë materiale qoftë biologjike siç janë gjurmët e gjakut, analizat e ADN-ës, raporti i autopsisë, shikimi i vendit të ngjarjes, batanija, teli i gjetur në trupin e viktimës dhe ai i gjetur në autoservisin C., të gjitha këto prova konkrete kanë peshën dhe rëndësinë e tyre për faktet relevante në raport me elementet e veprës penale që është shpallur fajtor i pandehuri.

Kolegji ka parasysh se në këtë çështje penale, nuk ka një provë të drejtpërdrejtë për veprimet e të pandehurit G., megjithatë provat materiale në këtë çështje penale që janë të tërthorta nxjerrin vetëm një konkludim siç edhe ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, që i pandehuri ka marrë pjesë në kryerjen e veprës penale të vrasjes për të cilën veprë penale është shpallur fajtor.

Nga rrethanat e fakteve, rezulton se: me datë 29.04.2009 i ndjeri kishte vdekur dhe se vdekja e tij ishte e dhunshme, kjo vërtetohet nga raporti i autopsisë, nr. MA09-119 i datës 09.10.2009, e cila konstaton konkluzionin përfundimtar se vdekja ka ardhur si pasoje e plagëve vdekjeprurëse në koke dhe e ndihmuar nga përshpejtimi i djegies së trupit në temperatura të lartë, nga raporti i ekspertizës të ADN-es: rezulton se eksperti F.A. kishte ekzaminuar gjurme që ishin marrë nga: Autoservisi Cali dhe nga Tepihu i bagazhit të automjetit Golf II, këto gjurme ishin krahasuar me mostrat e të ndjerit që kanë rezultuar të përputhshme gjurmët e marra me mostrat e të ndjerit në profilin e ADN-se, dhe se gjaku i marrë si gjurme i takonte të ndjerit. Nga batanija e cila ishte gjetur afër trupit të të ndjerit ndërmjet Fshatrave Smallushe dhe Dobratin, rezulton se të ngjashme me atë batanije ishin edhe tri të tjera në Autoservisin C.... Nga teli që ishte gjetur i lidhur i ndjeri në këmbë dhe duar rezulton se i njëjti tel ishte gjetur edhe në autoservisin C... Të gjitha këto prova vërtetojnë përtej çdo synimi, faktin se i ndjeri që ishte gjetur i vdekur ndërmjet fshatrave Smallush dhe Dobratin, ishte vrare dhe se vrasja ishte me mjet të fort mbretës siç kishte konstatuar raporti i autopsisë. Nga deklarata e dëshmitarit O., rezulton se ai kishte blerë shishen

me benzinë sipas kërkesës së të pandehurit G., e nga raporti i autopsisë është konstatuar se trupi i të ndjerit ka qenë i djegur, dhe si rrjedhojë e të gjitha këtyre provave rezulton vetëm një konkluzion se i pandehuri ka marrë pjesë në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë dhe se drejte gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar faktet në këtë çështje penale.

Më konkretisht Kolegji vlerëson se pretendimet e mbrojtjes, në kontekste të kundërthënieve të provave – deklaratave të dëshmitarëve, për faktet vendimtare nuk rezultojnë kundërthëniet. Siç rrjedhë asnjëri nga dëshmitarët, si vëllai i të ndjerit ashtu edhe bashkëshortja e të ndjerit pohojnë faktet thelbësore, se ditën kritike i ndjeri kishte qenë me të pandehurin G., dhe nga deklarata e këtyre dëshmitarëve ky është fakti më thelbësor nga se pas asaj dite i ndjeri nuk ishte shfaqur i gjallë por rezulton se ishte gjetur i djegur. Poashtu nga deklarata e vëllait të ndjerit – H. H.i, rezulton i provuar fakti se i ndjeri e kishte thirr i kishte kërkuar të hollat dhe ai ia kishte dërguar, e që i ndjeri i kishte deklaruar vëllait të tij se mund të më tradhtojnë por dije se unë jam me G.. Nga ana tjetër pas marrjes së të hollave që deklaronte dëshmitari vëllai i të ndjerit se ai ia kishte dhënë të ndjerit, kur ishte gjetur trupi i të ndjerit nuk rezulton se ishin gjetur në trupin e tij të hollat, poashtu nga SMS e dërguara nga ana e viktimës në drejtim të pandehurit vërtetohet fakti se i pandehuri i kishte borxh shumë prej 2.000 euro dhe ai i kishte kërkuar me SMS të dërguara me date, 14.03.2009 si dhe me datë 28.04.2009 ( një ditë para vrasjes të hollat nga i pandehuri që ia kishte borxh, andaj rrjedhë konkluzioni i drejt siç ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë se motivi kishte të bënte me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore.

Në këtë kontekst Kolegji vlerëson se deklarata e vëllait të ndjerit dhe bashkëshortes së tij, vërtetojnë disa fakte të rëndësishme për çështjen. Por që nuk kanë të bëjnë drejtpërdrejt me elementet e veprës penale, andaj edhe konsiderohen fakte të ndërmjetme, konkretisht këto deklarata vërtetojnë faktin, se i ndjeri dhe i pandehuri njiheshin dhe kishin një lloj bashkëpunimi në veprimtaritë e tyre të biznesit, se për herë të fundit i ndjeri kishte shkuar me të pandehurin, dhe se i ndjeri i kishte deklaruar vëllait të tij se do të më tradhtojnë por mbaje telefonin qel, e poashtu këto deklarata se ata kishin njohje se ata kishin bashkëpunim ndërmjet tyre në raportet biznesore, vërtetohet edhe nga SMS të dërguar nga ana e të ndjerit ndaj të pandehurit, ndërsa këto deklarata kanë ndërlidhshmëri të ngushtë me provat materiale, nga se rezulton se gjurmët e gjakut ishin gjetur në autoservisin e të pandehurit, dhe pas ditës që i ndjeri kishte shkuar me të pandehurin siç pohon dëshmitari H. H., “ ditën kritike e kishte thirrur në telefon i akuzuari dhe ai kishte dal me te dhe me nuk është kthyer në shtëpi” ( dëshmitari sqaron se i akuzuari e kishte thirrur të ndjerin ditën kritike dhe ata kishin dalur), poashtu dëshmitari thekson se, “ te nesërmen kam

shkuar ne ofiçinë dhe e kam takuar aty e kam pyetur për valluan ai me ka thënë nuk di gjë i kam thënë ju e keni marre dhe ju keni me ma kthyer se bashku me O.in” ( dëshmitari sqaron se ai ka shkuar ne ofiçinën e te pandehurit dhe ka pasur këtë bisedë me te pandehurin G. , kishte shkuar te i pandehuri dhe i kishte thënë ju e keni marrë dhe ju keni me sjell.

Sa i përket deklaratave të dëshmitarëve, E.B., Z.G. dhe L.RR., Kolegji siç ka theksuar veprimet e tyre në cilësinë e zyrtarëve policorë bien në domenin e autorizimeve të policisë që kanë të bëjnë me vendin e ngjarjes. Ndërsa këta dëshmitar përveç se kanë sqaruar se si kane sqaruar se çfarë kanë gjetur dhe shikuar në vendin e ngjarjes ku ishte gjetur trupi i të ndjerit si dhe në autoservis. Këta dëshmitar ne thelb nuk dëshmojnë për rrethanat e ngjarjes por dëshmojnë për rrethanat e çështjes së veprimeve operative të policisë lidhur me vendin e ngjarjes ku gjendej viktimja dhe vendin ku gjendeshin gjurmët. Rrjedhimisht Kolegji vlerëson se deklarata e këtyre dëshmitarëve nuk kanë kontradikta për faktet thelbësore, nga se ata kanë pohuar faktin se kanë qenë në vendin ku është gjetur trupi i viktimës dhe kanë sqaruar veprimet që kanë ndërmarr. Kolegji vlerëson se deklaratimet e dëshmitarëve – zyrtarëve policor se si kanë ardhur deri te informacioni që ndërlidhej autoservisi C... me këtë rast, nuk kanë relevancë, nga se përtej këtyre rrethanave që këta dëshmitarë kanë pohuar si kane ardhur deri te një informacion i tille, kanë rezultuar gjurmët e gjakut që janë marrë nga autoservisi C..., e të cilat gjurme gjaku me rastin e analizimit nga eksperti i ADN-ës, janë konstatuar se ato gjurmë të gjakut janë gjak njeriu dhe ato janë gjurmë janë në përputhshmëri të plotë në ADN me mostrat e të ndjerit.

Lidhur me deklarinimin e dëshmitarit F.R., që tregon për faktin se ka komunikuar me vëllain e të pandehurit nga Gjermania dhe ka dal sipas kërkesës së tij ku ka hasur në dy polic civil dhe babanë e të pandehurit, si dhe rrethanat qe ai ka treguar se policia kanë hyrë dhe dal nga autoservisi, e qe nuk kam parë vetura të policisë përveç golfit 5, rrethanat e tilla nuk janë relevante për Kolegjin e kësaj gjykate, nga se siç u theksua edhe me parë veprimet e policisë në autoservisin C... ndërlidhen me vendin e ngjarjes dhe gjurmët që kane rezultuar, ndërsa fakti që ky dëshmitar thekson se ai nuk është në dijeni që i pandehuri i ka pasur dikujt borxh apo dikush të pandehurit, për rrethanat e tilla rezulton se dy dëshmitarë thekson se ai nuk ka qenë në dijeni mirëpo fakti se dëshmitari nuk ka qenë në dijeni që i pandehuri ti ketë pasur dikujt borxh kjo nuk do te thotë se raporti i tillë i borxhit nuk ka ekzistuar, andaj se raporti i borxhit ndërmjet te pandehurit dhe të ndjerit ekzistonte vërtetohet përmes SMS-ve të dërguara nga ana e të ndjerit ndaj të pandehurit.

Kolegji i gjykatës së Apelit gjen se Gjykata e shkallës së parë, drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike.

Më konkretisht aktgjykimi i ankimuar në pjesën e dhënies së arsytimeve, ne faqen, 17, që i referohet deklaratave të dëshmitarëve, B. me anë të së cilës gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar, se i ndjeri me të pandehurin kanë pasur komunikim në telefon dhe atë dy ditë para rastit të vrasjes, e që kjo bisedë ishte për shkak se i pandehuri i kishte gjetur një veturë për ta blere, por që i ndjeri nuk e kishte blerë dhe se i ndjeri i kishte treguar dëshmitares se nuk e kishte blerë veturën, por se i pandehuri vetëm e kishte shëtitur neper male të Suharekës, ndërsa për këtë fakt se i pandehuri dhe i ndjeri kishin pasur kontakt për blerjen e veturës Golf V ka deklaruar edhe vëllai i te ndjerit – dëshmitari H. H., i cili poashtu kishte se i ndjeri i ka thënë, “ H. sjelli paret dhe veturën tek pompa Standard Benz se me thirri G.i që te shkojmë ta marrim një kerr Golf 5, dhe se pastaj i ndjeri e kishte njoftuar se nuk e kam blerë veturën por që G.i se bashku me O.in vetëm më kanë shëtitur neper Suharekë.

Poashtu në arsyetimin e aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë nga provat që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor ka arsyetuar faktet lidhur me vendin se ku ishte kryer vepra penale, e që në faqe, 18 gjykata në arsyetim të aktgjykimit ka dhënë arsye të mjaftueshme se mbi cilat prova ka ardhur ne konkludimin i ndjeri ishte vrarë në Autoservisin Cali, dhe se privimi kishte ndodhur në kohën dhe mënyrën siç ka konstatuar ne dispozitivit. Këto fakte rezulton se gjykata e shkallës së parë, i ka vërtetua nga provat materiale, që kanë të bëjnë konkretisht:

Nga gjurmët e gjakut, që kanë rezultuar nga akt ekspertimi i ADN-ës. Më konkretisht ne autoservisin C..., rezulton se janë marrë gjurmët e gjakut që janë evidentuar me shenjat si në vijim: VN#17.1, VN#17.2 dhe VN#17.3 te marra ne “ **bombolën e aparatin për salidm ne Autoservisin C..**”, këto gjurmë ne krahasim me mostrën e ADN së të ndjerit e evidentuar me shenjen A#3 përputhen me profilin e ADN se te ndjerit. Gjurma e gjakut e evidentuar me shenjen VN#18, e marre ne “ tavolinën e metalit ne autoservisin C...” kjo gjurmë në krahasim me mostrën e ADN se te ndjerit e evidentuar me shenjen A#3 përputhen me profilin e AND së të ndjerit.

Poashtu gjurmët e gjakut e evidentuar me shenjat, VN#19 e marrë në “ prizën elektrike që ishte afër derës ne autoservisin C...” gjurma e gjakut e evidentuar me shenjen VN 19.2 e marre ne “ **në murin e anës jugore që ishte afër derës se zyrës ne autoservisin C..**”, gjurma e gjakut me shenjen VN#19.3 e marrë në “ në anën jugore ndërmjet derës së zyrës dhe WC në autoservisin

C...” që të tria këto gjurmë kur janë krahasuar me mostrën e ADN-së së të ndjerit me shifrën A#3 kanë rezultuar se janë të përputhshme me profilin e ADN-ës së të ndjerit.

Gjurmët e gjakut të evidentuara me shenjen, VN#21 e cila është marrë në “ dyshtemenë afër derës së zyrës ne autoservisin C...”, gjurma e gjakut me shenjen VN#25 e marrë “ *nën tavolinën e drurit në oficinë – servisin e që ishte një leckë e përzier me njolla vaji për makina dhe njolla te gjakut*” të dy këto gjurmë që janë krahasuar me mostrat e ADN-ës së të ndjerit, të shënuara me shifrën A#3, kanë përputhshmëri me profilin e ADN-ës së të ndjerit.

Ndërsa, eksperti në shqyrtim gjyqësor poashtu ka sqaruar se këto gjurmë fillimisht janë konstatuar se kemi të bëjmë me gjak të njeriut dhe pastaj kur janë krahasuar kanë rezultuar se ato kanë përputhshmëri të plote me mostrat referente A1, A2 dhe A3, që kanë rezultuar se gjurmët e gjakut janë në përputhshmëri të plotë me gjurmët e mostrave të të ndjerit, dhe se përjashtohet ndonjë profil i ADN-ës së tillë përveç të ndjerit që ka këtë profil.

Kolegji vlerëson se gjykata mbështetur në këto gjurmë që i janë nënshtruar procesit të ekzaminimit shkencor, drejt ka vërtetuar se vendi ku ishte vrari i ndjeri rezulton Autoservisi C..., pasi që nga shumësia e gjurmëve të gjakut dhe mënyra se ku ishin gjetur ato përjashtohet çdo konkludim tjetër përveç përfundimit të drejt siç edhe ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë se i ndjeri ishte privuar nga jeta në autoservisin C....

Poashtu Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vërtetuar faktet kur ka konstatuar se pasi që i ndjeri ishte privuar nga jeta në autoservisin C... të njëjtin e kanë lidhur në kyçe të dorës dhe të këmbëve me tel i kanë vendosur qese të plastikes dhe e kanë mbuluar me batanije, e kanë vendosur në bagazhin e Veturës Golf II me targa ..... dhe e kanë dërguar ndërmjet fshatrave Smallushe dhe Dobratin, ku e lyejnë me benzinë dhe e djegin. Gjykata për këto fakte ka dhënë edhe arsyet në aktgjykim më konkretisht në faqe 20 dhe 21 të aktgjykimit të ankimuar.

Fakti se i ndjeri ishte mbuluar me një qese plastike dhe ishte lidhur me fije metalike – tel, vërtetohet nga raporti i shpejt i zyrës për personat e zhdukur pranë ministrisë së Drejtësisë raport ky me nr. EX09-31 i datës 30.04.2009 i cili raport është pjesë përbërëse e raportit të autopsisë, në pjesën e përshkrimit të trupit është konstatuar se: “ në koke kishte të vendosur një qese plastike mbi të cilën kishte të lidhur një fije metalike ( tel), i cili përshkonte në forme rrethore tere



perimetrin e fytyrës deri ne zgavrën e gojës. Poashtu është konstatuar se i ndjeri kishte të lidhur me fiqe metalike ( teli), kryqet e këmbëve.

Fakti se i ndjeri ishte dërguar deri në mes të fshatrave Smallush dhe Dobratin, për gjykatën e Apelit këto fakte rezultojnë të provuara drejt, pasi që, siç është theksuar nga provat – gjurmët e gjakut është provuar se i ndjeri është privuar nga jeta në Auutoservisin C... ( por se trupi i te ndjerit ishte gjetur ne një vend tjetër), ky Kolegj vlerëson se provat që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor kanë vërtetuar drejt faktin se i ndjeri ishte dërguar me veturën Golf deri në vendin ku ishte gjetur kufoma.

Këto rrethana faktike vërtetohen nga, gjurmët e gjakut që ishin siguruar në veturën Golf II me targa të regjistrimit, ..... pronë e te pandehurit G.R.. Më konkretisht gjurmët e gjakut që ishin siguruar në automjetin Golf II, të shënjuara me shenjen, VN#10.2 gjurme gjaku e marr në “ Bagazhin e Automjeitt Golf II, Gjurma e gjakut e shënjuar VN#10.3 e marre ne, “ bagazhin e automjetit Golf II”, gjurma e gjakut e shënjuar VN#10.4 e marr ne “bagazhin e automjetit Golf II”, qe te gjitha këto gjurme qe ishin marr nga dëshmia e shënjuar VN10.1 Tepihu i bagazhit Golf II, si të tilla me rastin e krahasimit me gjurmët e ADN së të ndjerit këto gjurmë gjaku të marra në bagazhin e automjetit rezultojnë se janë të përputhshme me profilin e ADN-së së të ndjerit N.H.. Nga këto gjurmë që janë vërtetuar në ekzaminimin shkencor se i takojnë të ndjerit, dhe fakti se kufoma ishte gjetur ne një vend jo ku ishte veprimi i privimit nga jeta por në një vend ndërmjet dy fshatrave Smallush dhe Dobratin vërtetohet përtej çdo dyshimi se i ndjeri pasi që ishte privuar nga jeta ishte dërguar deri në vendin ku ishte gjetur trupi i të ndjerit.

Fakti se trupi i te ndjerit ishte djegur, kjo vërtetohet nga Raporti i shpejt i përpiluar nga zyra për personat e zhdukur pranë Ministrisë se Drejtësisë që është pjese përbërëse e Autopsisë, që konstaton në pjesën e përshkrimit trupor, Trupi ndodhej me fytyrë drejt tokës, Gjatë ekzaminimit të jashtëm kemi vërejtur se pjesa më e madhe e trupit kryesisht ekstremitetet e poshtme pjesa e përparme abdominale dhe dora e djathtë ishin te djegura, konstatime këto që i mbështet edhe raporti i Autopsisë kur në konkluzione pika 4 konstatohet se trupi është i djegur dhe pika 5 konstatohet se “ ne trake është vërejtur prezenca e blozës se flanes ( zjarrit)”. Ndërsa po nga ky raport tek përshkrimi i vendit te ngjarjes është gjetur një kapak i shishes së plastikes, me mbishkrim “ Dea” dhe një shishe e plastike e shkrirë. Ndërsa dëshmitari O. ka pohuar se ditën kritike i pandehuri G. i ka kërkuar dëshmitarit që ai te blejë “një shishe benzinë dhe dy redbulla”, qe ai i ka blerë dhe ia ka dhënë. Se i ndjeri pasi që ishte privuar nga jeta në autoservisin cali edhe

ishte dërguar deri në vendin ndërmjet fshatrave Smallush dhe Dobratin e pastaj ishte djegur poashtu vërtetohet nga provat materiale që u theksuan më sipër.

Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vërtetuar gjendjen e fakteve kur ka konstatuar në dispozitiv se, pasi e thirrin të ndjerin në Autoservisin C... në mënyrë dinake e godasin në kokë në pjesën e pasme duke i shkaktuar plagë vdekjeprurëse.

Më konkretisht nga foto dokumentacioni i autopsisë, vërehen plagët e shkaktuara në pjesën e pasme të kokës së të ndjerit. Poashtu nga raporti i autopsisë, është konstatuar se, pjesa e pasme dhe anësoret e kokës sidomos ana e djathtë vërehet plage ndrydhëse shqyese te formës së çrregullt me madhësi deri ne 75mm x6 mm te formës shiritore dhe ne grupacione ( gjithsejtë 7) qe kane urreza indore dhe ne thellësi deri ne kafkën e kokës. Nga baza e kockës se kafkës vrojtohen frakturat thyerjet e kafkës si pasoj e dëmtimit nga veprimi i forcës se madhe te mjetit te forte mbretës. Ndërsa në përmbledhje të të gjeturave është konstatuar se, Viktima ka vdekur nga plagët e fituara nga goditjet me mjet të forte mbretës si dhe më pas e ndihmuar ( përshpejtuar) nga djegia e trupit ( veprimi temperaturave të larta).

Poashtu kolegji vlerëson se drejt ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë faktin kur ka konstatuar se i ndjeri është goditur në mënyrë dinake në pjesën e pasme të kokës, për çka ka dhënë gjykata e shkallës së parë edhe arsye lidhur me këto fakte. Se kishte veprim të goditjes në mënyrë dinake vërtetohet nga deklaratat e dëshmitarëve, H. H. vëllait të të ndjerit nga e cila deklaratave rezulton se i ndjeri me të pandehurin kishin marrëdhënie biznesore, poashtu nga deklaratat e dëshmitares B.H. bashkëshortes së të ndjerit që poashtu rezulton se i ndjeri me të pandehurin kishin marrëdhënie biznesore, e poashtu nga deklaratat e dëshmitarit O. që pohon faktin se ditën kritike i ndjeri kishte qenë në Autoservis. Prandaj marrë për bazë të gjitha këto deklaratime konkluzioni është i drejtë për sa i përket veprimit në mënyrë dinake nga ana e të pandehurit se bashku me personin N.N., nga se i pandehuri ka shfrytëzuar raportin e tij që kishte marrëdhënie për ta sjell deri në autoservisin C..., e nga provat – gjurmët e gjakut është vërtetuar se veprimi për shkaktimin e lëndimeve vdekjeprurëse rezulton si konkluzion i vetëm se ishte bërë në Autoservisin C.... Raporti i marrëdhënieve biznesore ishte vendimtar që të ekzistonte dinakëria duke shfrytëzuar besimin e të ndjerit pikërisht për shkak të këtyre marrëdhënieve që ekzistonin në biznes ndërmjet të ndjerit dhe të pandehurit.

Kolegji poashtu vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejte dhe ne mënyrë të plote ka vërtetuar faktet lidhur me lidhjen e këmbëve dhe të kokës me fije metalike ( tel), dhe se batanija që ishte gjetur ne vendin e ngjarjes ku ishte gjetur viktimia i takonte Autoservisit C..., e që poashtu fijet e telit që ishte gjetur ne autoservisin C... ishin të njëjta me ato që ishin gjetur në trupin e viktimës, por edhe qesja që ishte përdorur për mbështjelljen e kokës ishte qese e njëjtë me qeset e gjetura në autoservisin C... Kolegji vlerëson se për sa i përket fijeve metalike këto rrethana i ka sqaruar edhe eksperti mjekoligjor dr A.G., që ka pohuar se “ gjatë përgatitjes se trupit për autopsi nga këmbët i kam hequr një cope teli e cila ka qene e lidhur rreth e përqark pjesëve fundore te këmbëve, policia kishte sjellë edhe një copë teli qe e kishin marr ne një autoserivs dhe nga shikimi i qarte dukej i njëjtë me atë qe ka qenë i lidhur ne këmbët e te ndjerit”, poashtu qeset që janë gjetur ne autoservisin C... ishin të njëjta me qesen e gjetur në kokën e mbështjellë te viktimës, ndërsa fakti se batanija ishte e të njëjtit autoservis kjo vërtetohet me deklaratën e dëshmitari O., që ka pohuar se ata në punën e tyre në autoservisin C... kan përdorur katër batanije për mbulimin e gomave të automjeteve kur kanë bërë ngjyrosje, ndërsa në autoservis ishin gjetur vetëm tri batanije, dhe një batanije ishte gjetur pranë trupit të viktimës ndërmjet fshatrave Smallush dhe Dobratin, qe ne rrethana te tilla mund te vihet vetëm në konkludimin e drejtë dhe të plotë se viktimia ishte mbështjellë me batanije nga i pandehuri G. me të pandehurin NN me nofkën Qeli, dhe ishte dërguar nga autoservisi deri në vendin ku ishte gjetur viktimia.

Kolegji, ka parasysh se konkludimet për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike që i ka nxjerrë gjykata e shkallës së parë, janë të drejta dhe si të tilla rezultojnë në vërtetimin e të gjitha fakteve relevante për marrjen e vendimit te ligjshëm në këtë çështje penale. Kolegji si të tilla konkludimet e gjykatës së shkallës së parë për sa i përket fakteve që i ka vërtetuar i akcepton në tërësi, kjo për shkak se:

Nuk ka asnjë indicie fakt apo prove **të kundërt qe arsyetojnë**, se si kanë përfunduar gjurmët e gjakut të të ndjerit në autoservisin C... gjurmë të marra në autoservis dhe të ekzaminuara e të krahasuara me mostrat e gjurmëve biologjike të të ndjerit e te cilat janë përputhur tërësisht të plotë me profilin e ADN së të ndjerit, rrjedhimisht konkludimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejte dhe vërteton faktet se i ndjeri ishte goditur me mjet të fortë mbretes në Autoservisin C... te cilin i ishin shkaktuar plagë vdekjeprurëse.

Poashtu nuk ka asnjë indicie, fakt apo provë **që argumenton te kundërtën**, se si kishin përfunduar gjurmët e gjakut të të ndjerit ne bagazhin e automjetit Golf II pronë e të pandehurit G., andaj

rezulton konkludimi i vetëm i drejtë dhe i plotë e i logjikshëm se pasi që i ndjeri ishte goditur në Autoservisin c.... i ndjeri ishte bartur po me këtë automjet deri tek vendi ku ishte gjetur trupi i tij ndërmjet fshatrave Smallush dhe Dobratin, ky konkludim si i vetmi dhe i drejtë është ne përputhshmëri me provat shkencore – krahasimin e gjurmëve të gjetura ne bagazh të automjetit me gjurmët biologjike të të ndjerit që është përputhur profili i ADN dhe që ka rezultuar se ai gjak i gjetur në bagazh i takon të ndjerit.

Nuk ka asnjë indicie fakt apo prove **të kundërt** përveç konkludimit të drejtë se pasi që i ndjeri ishte dërguar ne vendin ku ishte gjetur trupi, ai ishte djegur dhe se vdekja kishte ardhur si pasojë e goditjeve por e përshpejtuar dhe ndihmuar edhe nga djegia e trupit. Konkludimi i tillë mbështetet në deklaratën e dëshmitarit O. që ka pohuar se ka blerë një shishe benzine sipas kërkesës së të pandehurit G. që ia ka dhënë, se në vendin e ngjarjes ishte gjetur një shishe e shkrirë, një kapak i shishes me mbishkrim “Dea”, nga raporti i ekzaminimit trupor vërtetohet se viktima është djegur ne ekstremitetet të poshtme dhe në dorën e djathtë e ne abdomen, nga autopsia vërtetohet se vdekja ka ardhur si pasojë e plagëve vdekjeprurëse të goditjes në kokë e ndihmuar edhe nga djegia e trupit – temperaturat e larta.

Nuk ka asnjë indicie, provë apo fakt **të kundërt** se si kanë përfunduar fijet e telit në trupin e viktimës, qesja e përdorur për mbështjelljen e kokës dhe batanija e gjetur tek vendi ku është gjetur viktima, përveç konkludimit të drejtë që ka nxjerrë gjykata e shkallës së parë se i ndjeri pasi që ishte goditur në autoservisin c...., i ishte vendosur një qese në koke, ishte mbështjellë me batanije shumëngjyrëshe dhe i ishin lidhur kyçet e këmbëve, dhe gjërat e tilla të batanijes, qeses dhe fija metalike i takonin Autoservisit C..., prandaj konkludimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe drejtë ka vërtetuar këto rrethana të fakteve.

Nuk ekziston asnjë indicie, prove apo fakt **i kundërt**, se pasi që i ndjeri ishte privuar nga jeta në autoservisin C... ishte lidhur me fije metalike mbështjellë me batanije dhe me qese në kokë ishte dërguar në vendin ku ishte gjetur viktima dhe ishte djegur, i pandehuri i kishte kërkuar O.it që ai të kontaktoj me vëllain e të ndjerit dhe ti thotë, “ Mos e kërko vëllain në polici pasi që ai ishte ne Shkup”, këto fakte përveç se provohen me deklaratën e dëshmitarit O., poashtu vërtetohen edhe nga raporti i policisë qe vërteton se telefoni dhe kartela e përdorur për ta thirrur numrin e telefonit të vëllait të të pandehurit, janë gjetur te O.i qe edhe i janë konfiskuar, rrjedhimisht kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar këto fakte mbi bazën e këtyre provave, e nga ana tjetër nuk ka asnjë prove që e vë në mëdyshje ekzistimin e këtyre fakteve.

Nga të gjitha këto arsye kolegji i gjykatës se Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të mbrojtjes së të pandehurit janë të pabazuara për sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe si të tilla janë refuzuar.

Për sa i përket pretendimit të mbrojtjes për shkeljen e ligjit penal, që mbrojtja thekson se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, e si pasojë ka ardhur deri te shkelja e ligjit penal, dhe se gabimisht është zbatuar neni 34 i KPK-ës dhe neni 147 par 3,5 dhe 7.

Kolegji vlerëson se pretendimet ankimore për shkelje të ligjit penal janë pjesërisht të bazuara. Kolegji rikujton se në aktgjykimin e ankimuar referenca e nenit 34 është zbatim i drejtë, pasi që siç ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, në dispozitivin e nenit 34, kjo dispozitë në Kodin e përkohshëm penal kod ky që zbatohet për të pandehurin nga se ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, kjo dispozitë rregullon qëllimin e dënimit, rrjedhimisht përderisa gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se i pandehuri është fajtor për veprën penale, aktgjykimi i është referuar edhe dispozitës që rregullon qëllimin e dënimit ndaj kryesit të veprës penale.

Lidhur me pretendimet e mbrojtjes se gabimisht është zbatuar neni 147 par 3,5 dhe 7 nga se në cilësim nuk mund të jenë paragrafi 3 dhe 5 sepse ato si të tilla përcaktojnë mënyrën e vrasjes mizorisht. Ky Kolegj vlerëson se pretendimi i tillë i mbrojtjes është i bazuar. Kjo për shkak se, veprimet e të pandehurit është kanë konsumuar forma e kryerjes së veprës penale nga paragrafi 7 i nenit 147, që konsiston se ka ekzistuar motivi për dobinë pasurore dhe dashja rezulton se është shpërfaqur për qëllim të realizimit të motivit të dobisë pasurore.

Ndërsa mënyra e kryerjes që ndërlidhet me dinakërinë që rezulton si fakt, nga deklaratat e dëshmitarëve vërtetohet se raportet e të pandehurit dhe të ndjerit ishin në relacione të biznesit e që rrjedhimisht rezulton se kishin ndërveprime dhe besim që pikërisht përdorimi i besimit të tillë të raporteve që kishin i ndjeri ka shkuar në autoservisin C.. ku edhe është goditur nga mbrapa, pra fakti se ishin në raporte të tilla rezulton besimi ndërmjet tyre që rrjedhë se i pandehuri ka keqpërdorur këtë besim të viktimës dhe fakti se ai ishte goditur me mjet të fortë nga mbrapa rrjedhë se veprimi ishte në mënyrë dinake e që inkrimohet në paragrafin 3 të nenit 147, e që ky kolegj dinakërinë e vlerëson në kuadër të rrethanave për dënimin si rrethanë rënduese, por që

nuk mund të ketë cilësim të trefishtë siç gjykata e shkallës së parë e ka shpallur fajtor për tre paragrafët nga neni 147.

Poashtu siç është vërtetuar se i ndjeri kishte vdekur si pasojë e dy faktorëve nga goditjet vdekjeprurëse dhe të përshpejtuara nga djegia në temperatura të larta, shpërfaqin veprimet mizore të të pandehurit të cilat veprime inkriminohen në paragrafin 5 të nenit 147, e që ky kolegji dinakërinë e vlerëson në kuadër të rrethanave për dënimin si rrethanë renduese, por që nuk mund të ketë cilësim të trefishtë siç gjykata e shkallës së parë e ka shpallur fajtor për tre paragrafët nga neni 147. Kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se motivi rezulton si thelbësor në këtë çështje penale, që nga provat dhe faktet vërtetohet se motivi ndërlidhet me qëllimin e të pandehurit për përfitim pasuror, konkretisht lidhur me mjetet monetare që i detyrohej i pandehuri të ndjerit, rrjedhimisht dashja rezulton se ishte e drejt për drejt që shfaqet nga faktet e çështjes në tërësinë e kryerjes së veprës penale, andaj për këto arsye kolegji gjen se pretendimet ankimore për sa i përket cilësimit juridik janë të bazuara nga se duhet të rezultojë cilësimi i drejt mbi formën dominuese të veprës penale të vrasjes së rëndë pavarësisht se rrethanat nën të cilat është kryer vepra penale shpërfaqin edhe dinakërinë dhe formën mizore, por që këto fakte të dinakërisë dhe të formës mizore duhet marr për bazë në rrethanat për dënim, andaj mbi këto arsye kolegji edhe e ka gjetur të bazuara pjesërisht ankesën e mbrojtëses së të pandehurit për sa i përket cilësimit juridik që ndërlidhet me zbatimin e ligjit penal.

Kolegji ka vlerësuar pretendimet ankimore të mbrojtjes së të pandehurit, për pretendimet ankimore të sanksionit penal, që mbrojtja thekson se përderisa vendimi është jo i drejtë rrjedhimisht edhe dënimi është jo i drejtë nga se ka rezultuar mbi aktgjykimin e paligjshëm, megjithatë mbrojtja thekson se, secili i pandehur përgjigjet për veprimet e tij, dhe se aktgjykimi nuk ka ndriçuar se cili ishte veprimi i të pandehurit dhe në çfarë mase në vrasjen e të ndjerit, a e ka goditur G. apo personi NN me nofkën Qeli apo të dy të ndjerin, a e ka lidhur i pandehuri G. apo personi NN me të një të ndjerin, cili nga këta i ka ve flaken, nëse motivi i të pandehurit G. ishte borxhi cili ishte motivi i personit NN, si gjykata ashtu edhe prokuroria kanë dështuar që të përshkruajnë veprimet individuale të pandehurit G. dhe personit NN me nofkën “Qeli” inekzistent.

Kolegji vlerëson se këto pretendime të mbrojtjes, ndërlidhen me aspektin ligjor të formës së bashkëpunimit që rezulton se ka të bëjë me bashkëkryerjen, siç është theksuar në arsyet e me sipërme kolegji ka dhënë arsyet për sa i përket bashkëkryerjes dhe se forma e bashkëkryerjes

shfaqet në dy forma duke marr rol secili bashkë kryes në veprën penale ku ndahen veprimet dhe rolet apo forma tjetër duke kontribuar thelbësisht, nga të gjitha provat rezulton se i pandehuri G. ka pasur kontribut thelbësor në kryerjen e veprës penale, nga se ekzistonte motivi i borxhit, ishin përdorur si prona e autoservisit të tij, automjeti Golf 2, sendet si fijet metalike, qesja dhe batanija, shishja me benzinë që i ishte kërkuar dëshmitarit O. që ta blej e që rezulton se viktima edhe ishte djegur, të gjitha këto fakte që janë të provuara vërtetojnë rolin thelbësor të të pandehurit në kryerjen e veprës penale të vrasjes. Fakti i motivit lidhur me të pandehurin NN me nofkën “ Qeli” kolegji këtë rrethanë të pretenduar e vlerëson të parakohshme, për të dhënë përgjigje nga se aktgjykimi i ankimuar nuk i referohet përgjegjësisë së personit NN me nofkën “Qeli”, ndërsa pretendimin se është inekzistent kolegji nuk e pranon pasi që ka të bëjë me faktin se ende nuk është i identifikuar, megjithatë përderisa nuk është arritur që të identifikohet kjo nuk nënkupton mungesën e ekzistencës së personit NN, kur nga deklarata e dëshmitarit O. vërtetohet prania e një personi NN në ditën kritike.

Ne këtë këndvështrim kolegji vlerëson se përderisa aktgjykimi nuk rezulton se është në kundërshtim me dispozitat ligjore rrjedhimisht edhe dënimi është në përputhshmëri me dispozitat ligjore, dhe se rrethanat e vlerësuara që kanë ndikuar në dënimin e të pandehurit ky kolegji i pranon në tërësi, ndërsa në mungesë të ndonjë rrethane lehtësuese që mbrojtja të pretendoj por edhe në mungesë të ndonjë rrethane lehtësuese që rezultojnë nga shkresat e lendes kolegji gjen se dënimi është në përputhje me dispozitat ligjore dhe me vet qëllimin e dënitimit. Marrë për bazë arsyet e dhëna me sipër kolegji vlerëson se roli i të pandehurit G. ishte shumë thelbësor në kryerjen e veprës penale të vrasjes, nga se rezulton motivi, nga se ishin përdorur sendet dhe prona e të pandehurit dhe tërësia e fakteve që janë dhënë më sipër si arsye vërteton rolin thelbësor të tij.

Kolegji ka parasysh edhe pretendimet e mbrojtjes që kur argumenton shkeljet esenciale dhe vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, i referohet vendimit të Gjykatës së Apelit PAKR.nr.185/2020 me të cilin vendim kjo çështje penale ishte kthyer në rigjykim. Ky kolegji ka parasysh se nuk ishte asnjë udhëzim specifik për marrjen e ndonjë prove në rigjykim për gjykatën e shkallës së parë, por kishte të bënte me mungesën e arsyeve në aktgjykimin e ankimuar paraprak të kësaj çështje penale.

Kolegji rikujton se arsyetimi në një çështje penale duhet dhe synohet që të ketë argumente shterruese të arsyeve për faktet që përshkruhen në dispozitiv, rrjedhimisht ky Kolegji nuk mund

të konsideroj se aktgjykimi është marrë në shkelje të dispozitave të procedurës penale, për shkak se paraprakisht ishte kthyer në rigjykim kjo çështje penale dhe si standard të vlerësoj arsyet e dhëna nga aktvendimi i gjykatës së Apelit, pasi që kemi të bëjmë me një rigjykim dhe objekt i shqyrtimit është aktgjykimi i prodhuar nga rigjykimi në këtë këndvështrim kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye shteruese për faktet vendimtare që shërbejnë për marrjen e vendimit të ligjshëm në këtë çështje penale, andaj edhe pretendimet që i referon mbrojtja në ankesë duke u mbështetur në aktvendimin e gjykatës së Apelit i gjen të pabazuara.

Poashtu kolegji ka parasysh dhe faktin lidhur me çështjen e “Çekanit” që ka qenë në mënyrë të vazhdueshme aspekt i shqyrtimit në këtë çështje penale. Fillimisht Kolegji vlerëson se nuk ka asnjë të dhënë në shkresat e lëndës për sa i përket faktit se ndaj të ndjerit është përdorur “Çekani” si mjet për kryerjen e veprës penale, kjo nuk rezulton as nga raportet e shikimit të vendit të ngjarjes, as nga konstatimet mjekoligjore, prandaj çështja e tillë e mjetit që rezulton se ishte aspekt i trajtimit sipas procesverbaleve të shqyrtimit gjyqësor, rezulton se ishte sajës nga ana e dëshmitarit, XH.R. i cili në shqyrtimin gjyqësor ka sqaruar rrethanat, mënyrën dhe shkakun e paraqitjes së këtij dëshmitari të mjetit të tillë “Çekani” si mjet që është përdorur në kryerjen e veprës penale, por që nga provat që janë administruar rezulton qartësisht se mjete të tillë nuk ishte as si indicie se është përdorur në kryerjen e veprës penale të vrasjes, që rrjedhimisht e bën deklaratën e dëshmitarit të sinqertë për faktet që ai ka sqaruar se ishte i ndikuar dhe i joshur financiarisht për tu paraqitur si dëshmitar dhe për të pretenduar se ai e dinte vendin ku ishte fshehur mjete të tillë (nga se “çekanin” e kishte gjetur në toke në fshatin Llugagji tek punëtorja e vëllait të tij), nga se ai vet pohon se “Çekani” ishte gjetur ishte lyer me gjakun e dhelprës dhe e kishte futur në një qese e kishte mbuluar me dhe pas 15-20 dite e kishte dorëzuar në EULEX, prandaj fakti se nuk ka asnjë provë për të konstatuar mjetin e tillë si mjet të kryerjes së veprës penale rrjedh e sinqertë deklarata e këtij dëshmitari se në të vërtetë ai ishte ndikuar dhe joshur financiarisht për të krijuar një inskenim të tillë lidhur me mjetin që ishte poashtu çështje e trajtimit në këtë shqyrtim gjyqësor, e që rrjedhimisht aktvendimi i gjykates së Apelit e kishte anuluar aktgjykimin paraprak edhe për këtë arsye lidhur me mjetin dhe mungesën e arsyeve për këtë mjet, që edhe gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar e ka dhënë vlerësimin për sa i përket kësaj rrethane të këtij mjete – çekanit, e që ka qenë poashtu udhëzim nga gjykata e Apelit, por poashtu edhe lidhur me bykun ka dhënë arsyet gjykata e shkallës së parë që poashtu kanë qenë udhëzime të gjykatës së Apelit.



Andaj për të gjitha këto arsye kolegji vlerëson se pretendimet ankimore të mbrojtjes në ankesën kundër aktgjyqimit janë të pabazuara.

Lidhur me pretendimet e përfaqësuesit të të dëmtuarit, av. B.T. për sanksionin penal që ka propozuar në Gjykatën Apelit që të pandehurit të shqiptohet një dënim më i ashpër, kolegji këto pretendime i ka gjetur të pabazuara.

Kolegji vlerëson se pretendimet për një dënim më të ashpër i referohen rrethanave të ngjarjes së veprës penale, çka konsiston se ato si të tilla janë marr për bazë nga gjykata e shkallës së parë kur ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 30 vitesh. Më konkretisht kolegji vlerëson se pretendimi i mbrojtjes se gjykata e shkallës së parë ka nënvlerësuar rrezikshmërinë e veprës penale, ky pretendim është i pabazuar nga se rrezikshmëria në rastin konkret ndërlidhet drejtpërdrejt me rrethanat nën të cilat është kryer vepra penale, e që përcaktimin e rrezikshmërisë së cenimit të vlerës së mbrojtur e ka përcaktuar ligjdhënësi, ndërsa rrethanat nën të cilat është cenuar vlera e mbrojtur – jeta e të ndjerit gjykata i ka marrë për bazë, dhe atë faktin e shfrytëzimit të miqësisë me të ndjerin dhe të pandehurin – besimin që kishin, mashtrimin kinse po ia kthen borxhin veprimin e pabesë dhe brutal e të pamëshirshëm, qëllimin e të pandehurit për të fshehur gjurmët e krimit kur dërgohet viktimi në vend tjetër dhe djegien e trupi, të gjitha këto kanë të bëjnë me rrethanat nën të cilat ishte kryer vepra penale që në lidhshmëri me rrezikshmërinë shoqërore janë vlerësuar si rrethana rënduese. Andaj pretendimet e mbrojtjes për një dënim më të ashpër ndaj të pandehurit në mungesë të ndonjë rrethane tjetër rënduese përveç se atyre që i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, ky Kolegj i gjen të pabazuara.

Andaj për arsyet e theksuara si me lartë kjo Gjykatë bazuar në nenin 403 të KPRK-ës, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

APS.nr.3/2023 me datë 20.02.2023

B.profesionale  
Alba Makolli

Anëtarët e kolegjit  
Burim Ademi

Kryetar i kolegjit,  
Bashkim Hyseni

Numri i lëndës: 2019:091212  
Datë: 27.03.2023  
Numri i dokumentit: 04125229

Ferit Osmani

---